

Në bazë të Nenit 8 të Ligjit të Punës (Ligji nr. 03/L-212), dhe Udhëzimin Administrativ (MFPT) Nr. 01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, neni 3, pika 1.2, N.P"Termokos" Sh.A në Prishtinë me datë: 29.07.2024 shpall:

KONKURS TË BRENDSHËM PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS

Titulli i pozitës: Zyrtar i njësisë së kontrollit - një (1) vend pune

Titulli i mbikëqyrësit: Drejtorit të Departamentit të Distribuit

Kohëzgjatja e kontratës: Në afat të pacaktuar

Lartësia e pagës mujore: 808.64 euro

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Në bashkëpunim me inxhinierët përgjegjës të rajoneve ndikon në realizimin e detyrave të punës gjatë sezonës së nxemjes dhe gjatë periudhës së realizimit të planit aksional.
- Me qëllim të informimit të drejtorit të departamentit, përpilon raporte ditore, javore dhe mujore për të gjeturat gjatë punës së personelit të departamentit.
- Me qëllim të përmirësimit të punës dhe rritjes së performancës së departamentit, jep këshilla dhe sygjerime për probleme specifike.
- Ushtron kontrollë mbi funksionimin e departamentit në funksion të mirëvajtjes së punës së departamentit.
- Është përgjegjës për evidentimin e lëshimeve në punë nga ana e punëtorëve të departamentit.
- Mban evidencë dhe kujdeset që departamenti të jetë i furnizuar me materiale dhe pajisje të natyrave të ndryshme: materiale instaluese, vegla pune, pajisje mbrojtëse etj.
- Kordinon punën mes njësive të Distribuit me qëllim të plotësimit të nevojave me pajisje dhe personel për raste specifike.
- Me kërkesën e udhëheqësit të sektorit apo drejtorit të departamentit, është i obliguar që të kryen edhe detyra tjera të afërta me profesionin dhe vendin e punës.
- Nëse me veprim apo mos veprim, me dashje apo nga pakujdesia i shkakton dëm Termokosit është i obliguar që dëmin ta kompensoj;
- Kompensimi i dëmit nuk nënkupton shmangie nga përgjegjësia disiplinore, kundervajtëse dhe penale;
- Evaluimi i performancës bëhet për çdo fundviti.

Kualifikimet dhe përgatitja profesionale

- Bachelor/Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike/Ekonomik ose fushë tjetër relevante.
- Tri (3) vite përvojë pune.
- Njohja e gjuhës angleze (e preferuar).
- Përdorim profesional i produkteve të MS-office.
- Niveli i lartë të iniciativës, angazhimit, motivimit, vendosmërisë, intuitë dhe vemendje në detaje.
- Nivel të lartë i etikës profesionale.

Aplikantët e interesuar për vendet e punës duhet të bashkëngjisin këto dokumente:

1. Aplikacionin e plotësuar;
2. CV e aplikantit;
3. Dëshminë e kualifikimit shkollor;
4. Dëshminë mbi përvojën e punës;
5. Dokumentin e identifikimit - letërnjoftimi i fotokopjuar;
6. Kopje të certifikatave, referencave tjera profesionale që ndërlidhën me pozitën që aplikoni.

Mënyra e aplikimit: Kandidatët mund ta shkarkojnë aplikacionin për punësim që gjendet në ueb faqen e Termokos - së www.termokos.org;

Aplikacionet duhet të dorëzohen vetëm në mënyrë elektronike në emailin: Burimet.njerezore@termokos.org,

Pas dërgimit të email-it ju do të pranoni konfirmimin nga ne. Nëse nuk keni pranuar konfirmimin, atëherë kontaktoni në nr. tel 038 541 - 780.

Konkursi i brendshëm do të jetë i hapur në afat prej 15 ditësh nga data e publikimit në ueb faqe www.termokos.org.

Mbyllja e konkursit bëhet më datë: 13.08.2024, ora 24.00.

Vërejtje: Pranohen vetëm dokumentacioni i punonjësve të Ndërmarrjes "Termokos" (sepse është konkurs i brendshëm).

Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas afatit nuk do të shqyrtohen.

Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit

1. Vlerësimi i kandidatëve zhvillohet nëpërmjet testimit me shkrim dhe intervistimit;
2. Procedura e vlerësimit të konkursit të brendshëm përmbanë gjithsej 100 pikë, ku kalueshmëria është arritja e së paku pesëdhjetë e pesë 55 pikëve nga të gjitha fazat e konkursit;
3. CV i kandidatit vlerësohet deri në dhjetë 10 pikë;
4. Testi me shkrim deri në shtatëdhjetë 70 pikë;
5. Intervistimi deri në njëzetë 20 pikë.

Kalendari i përafërt: Bazuar në UA 01/2024 nenin 7 pika 1.11, procedura e rekrutimit të përafërt do të përfundojë brenda nëntëdhjetë (90) ditëve.